




Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	18.01.2024	4	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMBEL	331/2024		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1430/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani anëtar, me Kaltrina Avdullahi Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1430/2023, të datës 21.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat në çështjen juridike „Kompensimi material“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim më datë 18.01.2024 mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1430/2023 e datës 21.11.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Akt Emërimit me numër Nr.170 të datës 01.11.2017 në pozitën e punës „Inspektor Shëndetësor“ në kuadër të Inspektoratit Shëndetësor. Më datë 03.08.2023 ankuesja përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar avokat Adrian Megjani ka parashtruar kërkesë-ankesë me numër protokolli 05-4724 në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e lartë drejtues si dhe kompensimin retroaktiv të diferencës së pagës nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e lartë drejtues që nga emërimi „Zëvendësuese e Kryeinspektorit“ në Inspektoratin Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Vendimit me numër Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022 të U.D të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit nuk i ka kthyer përgjigje.

Ankuesja e pakënaqur me mos përgjigjen e organit të punësimit me date 07.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me date 24.10.2023 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr Vendim me numër A.nr.1149/2023 përmes së cilit e ka detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të

MSH-së të shqyrtoj kërkesën-ankesën me numër protokollit 05-4724 të datës 03.08.2023 si dhe te nxjerr akt administrativ.

Ndërsa Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë më datë 03.11.2023 ka dhënë përgjigje në ankesë, me arsyetimin se për të fituar koeficient të pagës të nivelit të lartë drejtues, duhet fillimisht të zgjidheni apo të emëroheni Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit Qendror, pasi funksionalizimit të Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë.

Kundër përgjigjes me numër protokollit Nr.05-6991/3 të datës 03.11.2023 të Zëvendësuesit të Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat _____ më datë 21.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7050/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkelje të procedurës administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Shëndetësisë. Ndërsa Këshilli më datë 01.12.2023 ka pranuar nga kjo e fundit përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar me numër Nr.prot.1237/2023 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër: VK/2023 dhe numër protokollit Nr.prot.28/2024 të datës 03.01.2024 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1430/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 7050/2023 të parashtruar më datë 21.11.2023 nga ankuesja përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar avokat _____ Përgjigjen në kërkesë të datës 03.11.2023; Vendimin me numër A.nr.1149/2023 të datës 23.10.2023; Autorizimin e datës 28.07.2023; Vendimin me numër 056844 të datës 22.12.2022; Ankesën me numër 05-4724 të datës 03.08.2023; Vendimin me numër A.nr.332/2023 të datës 29.03.2023; Listën e pagave për muajin qershor 2023; Dëshminë nga Ligji për Pagat në Sektorin Publik; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.11.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 01.12.2023; Njoftimin me numër 05-6991/2 të datës 03.11.2023; Dëshminë e datës 24.04.2023; Akt Emërimit me numër Nr.170 të datës 01.11.2017; Listën e pagave; E-mailin e datës 12.07.2023; Vendimin me numër protokollit 28/2024 të datës 03.01.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e palejuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i provave materiale ka konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër Nr.170 të datës 01.11.2017 është emëruar

në pozitën „Inspektor Shëndetësor“ në Inspektoratin Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë me koeficient tetë (8) sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa e njëjta në bazë të dëshmimeve të ofruara nga palët në procedurë sipas Vendimit me numër Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022 të U.D të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë është caktuar si Zëvendësuese e Kryeinspektorit në Inspektoratin Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë. Ankuesja [REDACTED] që nga marrja e detyrës gjegjësisht që nga fillimi i ushtrimit të detyrës si Zëvendësuese e Kryeinspektorit në Inspektoratin Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Vendimit me numër Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022 të U.D të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë është paguar me pagën e drejtuesit të nivelit të mesëm, ashtu sikurse kanë qenë duke u paguar edhe pararendësit e saj.

Tutje, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjithashtu ka konstatuar se ankuesja më datën 03.08.2023 ka parashtruar kërkesë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e lartë drejtues si dhe kompensimin retroaktiv të diferencës së pagës nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e lartë drejtues që nga emërimi „Zëvendësuese e Kryeinspektorit“ në Inspektoratin Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Vendimit me numër Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022 të U.D të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit nuk i ka kthyer përgjigje. Ankuesja e pakënaqur me mos përgjigjen e organit të punësimit me date 07.09.2023 ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me date 24.10.2023 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr Vendim me numër A.nr.1149/2023 përmes së cilit e ka detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të MSH-së të shqyrtoj kërkesën-ankesën me numër protokollit 05-4724 të datës 03.08.2023 si dhe të nxjerr akt administrativ.

Zëvendësuesi i Udhëheqësi i Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë me datë 03.11.2023 përmes përgjigjes në kërkesën me numër protokollit nr.05-6991/3 e ka njoftuar ankuesen se Inspektorati Shëndetësor aktualisht funksionon në bazë të Ligjit Nr.02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor (viti 2006) me të cilin ligji Inspektorati Shëndetësor është organ administrativ i Ministrisë, ashtu siç janë edhe Inspektorati Farmaceutik dhe Inspektorati Sanitar. Gjithashtu ka njoftuar se Ministria e Shëndetësisë është në proces të hartimit të ligjit të ri për themelimin e Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë i cili do të udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit Qendror, e i cili do të ketë gradën nivel i lartë drejtues, dhe se për të fituar koeficient të pagës së nivelit të lartë drejtues duhet fillimisht të zgjidheni apo emëroheni Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë, pas funksionalizimit të Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë.

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen me numër protokollit Nr.05-6991/3 të datës 03.11.2023 të nxjerre nga Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, parashtron ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkelje të procedurës administrative, respektivisht ankuesja pretendon se përgjigjja e lartpërmendur e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Shëndetësisë është nxjerr ne kundërshtim me legjislacionin në fuqi respektivisht e njëjta kërkon aprovimin në tërësi të ankesës lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e lartë drejtues si dhe kompensimin retroaktiv të diferencës së pagës



nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e lartë drejtues që nga emërimi „Zëvendësuese në pozitën e Kryeinspektorit“ në Inspektoratin Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Vendimit me numër Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022 të U.D të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik (i aplikueshëm nga data 10.07.2020 deri me datë 26.09.2023), konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e shërbimit civil sipas këtij ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën kur ankuesja është caktuar Zëvendësuese e Kryeinspektorit“ ndërlidhur më këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: *“Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë që i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik, ndërsa neni 125 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se: “1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: heshtja administrative)”* pastaj me dispozitat e nenit 127 paragrafin 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *„1. Ankesa duhet të parashtrohet nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ“* si dhe 4. *“Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ“*. Përkatesisht sipas këtyre dispozitave ligjore rezulton se çdo nëpunës civil i cili pretendon një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) të organit gjegjes të punësimit, ka të drejtë të parashtrij ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu, në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankueses, Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga ana e organit të punësimit dhe ankuesja, nuk ka gjetur dëshmi se ankuesja ka parashtruar kërkesë ose ankesë tek Ministria e Shëndetësisë apo në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e lartë drejtues si dhe kompensimin e diferencës së pagës nga niveli i mesëm drejtues në nivelin e lartë drejtues që nga emërimi „Zëvendësuese e Kryeinspektorit“ në Inspektoratin Shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë sipas Vendimit me numër Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022 të U.D të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, deri më date 03.08.2023 kur ka parashtruar kërkesë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë edhe përkundër se e njëjta detyrën e „Zëvendësueses së Kryeinspektorit“ ka filluar ta ushtroj nga data 22.12.2022 dhe është paguar me pagë të nivelit të mesëm drejtues, e që nënkupton që kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi që ankueses afati i ankimimit ka filluar ti rrjedh nga momenti kur ankuesja nuk e ka pranuar pagën e nivelit të lartë drejtues në llogarinë bankare për muajin kalendarik sipas Vendimit me numër Nr.178/XII/2022 të datës 22.12.2022 të U.D të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, që rezulton se ankuesja nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike brenda afatit të përcaktuar ligjor, sipas dispozitave të lartë cekura gjegjësisht këtë kërkesë ankuesja ka pasur të drejtë ta parashtrij në muajin shkurt të vitit 2023. Kështu që në vlerësim të Kolegjit

ankesa e ankueses e datës 21.11.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas numrit të protokollit 7050/2023 është e parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ", si dhe nenit 127 paragrafit 4 me të cilin parashihet se: 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesja nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimimit brenda afateve ligjore sipas dispozitave të lartpërmendura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa me numër protokollit 7050/2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankueses është e pasafatëshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1430/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Avokatit
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

